



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

5269/3
Nr. Prot.

3282

Tiranë, më 11/11/2022

URDHËR

Nr. 596 datë 11/11/2022

PËR

PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM NGA DETYRA TË NOTERIT [REDACTED],
PËR GJITHË PERIUdhËN E KOHËZGJATJES SË MASËS SË SIGURIMIT "ARREST
NË SHTËPI"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 56, shkronja "a" të Ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Në datë 01.06.2022 nga informacionet e përfituara nga mediat audiovizive lidhur me shtetasin [REDACTED] Ministria e Drejtësisë ka evidentuar se në kuadër të hetimit penal të kryer nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë janë arrestuar 3 persona të dyshuar për veprat penale "shpërdorim i detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndër të cilët edhe noteri z. [REDACTED]

Lidhur me informacionet e përfituara nga media, në referim të parashikimeve të pikës 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", sanksionohet se "1. Ministri i Drejtësisë fillon hetimin kryesisht, bazuar në të dhëna thelbësore dhe mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se mund të jetë kryer një shkelje. Informacionet që përfshihen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht."

Në zbatim të pikës 1 në raport me parashikimet e fjalisë së dytë, pika 3 e nenit 32 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, për rastet kur ndaj noterit është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil, sanksionohet se "... Gjykata, prokuroria ose institucione të tjera i dërgojnë Ministrinë të Drejtësisë pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procedimit përkatës."

Ndërkohë, në zbatim të shkronjës a) të nenit 56, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", parashikohet se "Noteri ose zëvendësnoteri pezullohet përkohësisht nga detyra me vendim të Bordit Disiplinor, kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale, përgjatë gjithë periudhës së arrestit në burg ose arrestit në shtëpi;".

Lidhur me fillimin e procedurës së pezullimit dhe njoftimet për Bordin Disiplinor, në shkronjën b) të nenit 57 dhe pikën 1 të nenit 58 të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", sanksionohet se:

Pezullimi nga detyra i noterit ose zëvendësnoterit, sipas nenit 56, të këtij ligji, mund të vendoset nga Bordi Disiplinor:

a) me nismën e vet;

b) me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë ose mbi bazën e njoftimit, sipas parashikimeve të nenit 58 të këtij ligji.

1. Titullari i institucionit përgjegjës informon Bordin Disiplinor menjëherë me marrjen e dijeni të fakteve të renditura në nenin 56 të këtij ligji.

Në zbatim të dispozitave ligjore, Ministria e Drejtësisë ka informuar Bordin Disiplinor mbi informacionet e përfituara nga mediat audiovizive, si dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë lidhur me noterin Aleko Anagnosti, duke propozuar pezullimin nga detyra të noterit [redacted] sipas parashikimeve të nenit 56 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.

Pas verifikimeve të kryera nga Bordi Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Noterisë, me kërkesë për informacion, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, është konfirmuar zyrtarisht nga kjo e fundit me shkresë nr. 1766/1 prot., datë 10.10.2022, se me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. 23-2022-138 Akti, datë 31.08.2022, është caktuar masa e sigurimit personal "arrest në shtëpi", ndaj shtetasit [redacted] për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre", e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Sa më sipër, në kushtet kur Ministria e Drejtësisë ka informuar Bordin Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë mbi faktet e raportuara në mediat audiovizive për vendimarrje sipas parashikimeve të nenit 56 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, si dhe pas administrimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. 23-2022-138 Akti, datë 31.08.2022, përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, me vendimin nr. 4/2022 datë 17.10.2022, Bordi Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Noterisë ka vendosur "Pezullimin nga detyra të noterit [redacted] Noter i Dhomës së Noterisë Sarandë, për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit "Arrest në shtëpi", në bazë të nenit 56, shkronja "a" të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për noterinë".

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të pikës "a", të nenit 56 e vijues, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e përkohshëm nga detyra të noterit [REDAKTUAR], Noter i Dhomës së Noterisë Sarandë, për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit "Arrest në shtëpi".
2. Caktimin e një noteri për administrimin e arkivës noteriale, deri në përfundim të afatit të pezullimit të Licencës sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij urdhëri.
3. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj. [REDAKTUAR], Specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Znj. [REDAKTUAR], Specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë, Gjirokastrë.
4. Administrimin e vulave respektive në sektorin arkiv-protokoll pranë Ministrisë së Drejtësisë, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit [REDAKTUAR], deri në përfundim të afatit të pezullimit të Licencës sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij urdhëri.
5. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.
6. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivore, nëse ka të tilla.
7. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.


8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.

9. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja



~~XXXXXXXXXX~~
~~XXXXXXXXXX~~

